



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **20.03.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **2A Group SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** nxjerr:

V E N D I M

1. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik **2A Group SH.P.K** e dt. 20.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 15.03.2024.
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 15.03.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **2A Group SH.P.K** me date 20.03.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i QKMF ne Drenas"** me Nr. të Prok: **206-23-6378-5-1-2**. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas **2A Group SH.P.K**:

- Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminim
- F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK
- Neni 68 paragrafi 4, Gjendja Ekonomike dhe Financiare,
- Neni 69 paragrafi 8, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,
- Neni 71 paragrafi 4, Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik
- Dispozitat e Ligjit Nr. 06/L -016 mbi Shoqëritë Tregtare
- Neni 35 paragrafi 6, Regjistrimi Fillestar i Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtar

Interpretimi 18 i datës 22.11.2022 të E-Prokurimit, **A lejohet një kompani të mbështet në kapacitetet e degëve të saja, apo duhet të marrë pjesë vetëm si grup i operatorëve ekonomik?**

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ne si grup i Operator Ekonomik me datë 15.03.2024 kemi pranuar letren standarde për tenderuesin e eliminuar gjatë vlersimit të tenderit me pretendimin e Autoritetit Kontraktues se tenderi ynë ka pasur mangësi sa i përket dokumentacionit të ofruar, "Në ofertën e dorëzuar në platformën e E-Prokurimit keni ofruar ISO Certifikatat e kërkuara vetëm për njërin anëtar të konzerciumit dhe Kërkesa për ISO tek Përshtatshmëria Profesionale është obligim për gjithë partnerët e konzerciumit sipas nenit 26 të Rregullores NR.001/2022 për Prokurim Publik" "Kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001...secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimeve", me ç'rast AK-ja ka ardhur në përfundim se kinse oferta jonë është e papërgjegjshme.

1 Përgjigje mbi pretendimin e AK-së për eliminim nga tenderi

Grupi i Operatorëve Ekonomik, 2A Group SH.P.K dhe 2T SH.P.K paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim me pretendimet për shkelje të natyres absolute, të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës neni 68 paragrafi 4 i LPP-së, Gjendja Ekonomike dhe Financiare, neni 69 paragrafi 8, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, neni 71 paragrafi 4 i LPP-së Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik, Neni 7 i LPP-së, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim, Ligjin Nr. 06/L -016 mbi Shoqëritë Tregtare. AK-ja me qëllime të caktuara ka përdorur një interpretim të KRPP-së, i cili fare nuk nderlidhet me rastin konkret. Arsyetimi për eliminimin tone është apsolutisht i paqëndrueshëm, i pavërtetë dhe i rrejshëm. AK-ja ka pretenduar se kinse ne nuk kemi paraqitur certifikatat ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, për anëtarin e konzerciumit 2T SH.P.K dega në Kosovë por ka pohuar se ne kemi paraqitur këto certifikata për Operatorin Ekonomik 2T SH.P.K NIPT;KO1731001M me adresë; Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H.4, AP 5, Tiranë, Albania. AK-ja nuk ka denjuar që të lexoj saktë as Ligjin e Prokurimit Publik as interpretimet e KRPP-së të cilat saktësisht shpjegojnë një situatë të tillë.

Në Webfaqën e KRPP-së interpretimi nr.18 i datës 22.11.2022 e përcakton saktë; **"A lejohet një kompani të mbështet në kapacitetet e degëve të saja, apo duhet të marrë pjesë vetëm si grup i operatorëve ekonomik".** Andaj, po të lexohej ky interpretim i cili thotë se "...në rast se një operator ekonomik i cili operon me degët e saja në disa vende (shtete) të tjera, mund të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja për t'i përmbushë kërkesat lidhur gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale duke ofruar me tender dëshmitë përkatëse dhe për këtë qëllim nuk mund të diskualifikohet i njëjti pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik", atëherë AK-ja do ta kuptonte se oferta jonë është e përgjegjshme dhe është në përputhshmeri të plotë me kërkesat në Dosjen e Tenderit, sepse kompania 2T SH.P.K dega në Kosovë është degë e shoqërisë të huaj tregtare, përkatësisht është degë e shoqërisë 2T SH.P.K Tiranë.

Gjithashtu, edhe ligji për shoqëritë tregtare përkatësisht neni 35 paragrafi 6 e përcakton qartë se **"Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare nuk është person juridik i ndarë ose i veçantë nga Shoqëria e Huaj Tregtare që e ka themeluar atë"**. Edhe pse ligji është i qartë e i saktë edhe pse interpretimi numer 18 datës 22.11.2022 i publikuar nga KRPP-ja flet dhe spjeron saktë dhe qartë situatën e tillë, përsëri kjo nuk i ka mjaftuar AK-së që të vlerësoj drejtë ofertën tonë sepse jemi të bindur se qëllimi i tyre nuk është vlerësimi i drejtë i ofertave.

Si përfundim, kërkojmë nga AK-ja që të marrë vendim për aprovimin e kërkesës për rishqyrtim dhe të kthehet lënda në rivlerësim dhe ofertën tonë ta konsideroni si të përgjegjshme mbi bazën e ligjit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e dispozitave të mesiperme, tentojnë të shkaktojnë dëme të mëdha kompanisë tona, të cilat përpos dëmeve materiale që kanë të bëjnë me shpenzimet e ofertimit në këto aktivitete dhe fitimit të munguar, gjithashtu tentojnë të na shkaktojnë dëme të mëdha edhe në imazhin e kompanisë sonë.

Përgjigjia e Autoriteteit Kontraktues në lidhje me pretendimin Ankimore

AK-MSh i konsideron si të pabazuara pretendimet e juaja ankimore, bazuar në këto fakte:

Interpretimi i KRPP-së i datës 14.10.2022 përcakton:

94. 14.10.2022 A lejohet një kompani të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja, apo duhet të marrë pjesë vetëm si grup i operatorëve ekonomik?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, një operator ekonomik për t'u konsideruar i përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues, **duhet t'i plotësojë të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.**

Paragrafi 4 i nenit 68 i LPP-së lidhur me **Gjendjen ekonomike dhe financiare**, përcakton:

"4. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera".

gjithashtu,

Paragrafi 8 i nenit 69 të LPP-së lidhur me **Aftësitë teknike dhe/ose profesionale**, përcakton:

"8. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai në këtë rast duhet të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete në vend burimet e nevojshme në dispozicion të operatorit ekonomik. Nën të njëjtat kushte një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera".

ndërsa,

Paragrafi 4 i nenit 71 të LPP-së lidhur me **Grupin e operatorëve ekonomik**, përcakton:

"4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit".

Në përputhje me dispozitat e lartë cituara, në rast se një operator ekonomik i cili operon me degët e saja në disa vende (shtete) të tjera, mund të mbështetet në kapacitetet e degëve të saja për t'i përmbushë kërkesat lidhur gjendjen ekonomike dhe financiare apo lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale duke ofruar me tender dëshmitë përkatëse dhe për këtë qëllim nuk mund të diskualifikohet i njëjti pse nuk ka marrë pjesë si grup i operatorëve ekonomik.

E pa pranueshme do të konsiderohej nëse operatori ekonomik me degët e saja dorëzojnë individualisht tenderë në një aktivitet prokurimi që ka për qëllim dhënien e një kontrate publike, sepse një pjesëmarrje e tillë do të dëmtonte konkurrencën, në fakt do të krijonte konkurrencë të pa ndershme.

Gjithnjë në përputhje me dispozitat e lart cituara, është e drejtë e çdo Operatori Ekonomik i cili nuk mund t'i përmbushë si i vetëm kërkesat e parashtruara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë lidhur me **gjendjen ekonomike dhe financiare** apo lidhur me **aftësitë teknike dhe/ose profesionale**, të mbështetet në kapacitetet e një subjekti (ve) tjetër, apo të marrë pjesë në grup të operatorëve ekonomik (konzorcium). Dallimi qëndron vetëm tek përgjegjësia. Në rastin e mbështetjes, përgjegjës për ekzekutimin e kontratës është operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera, ndërsa në rastin e Grupit të Operatorëve Ekonomik, grupi është individualisht dhe bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës.

Gjithashtu , interpretimi I KRPP i datës 22.06.2023 përcakton:

29. 22.06.2023 Sipas nenit 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se AK kërkon Certifikatë që vërteton përshtatshmërinë e produktit me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, në rast grupi të operatorëve, certifikata e tillë a duhet të kërkohej nga të gjithë anëtarët e grupit apo mjafton njëri nga ata të jetë i pajisur me këtë certifikatë?

Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standartet përkatëse".

Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001..., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë

të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit.

Kërkesa e përcaktuar ne DT për këtë aktivitet nga ana e Ministrisë se Shëndetësisë është kërkesë e përshtatshmërisë profesionale:

Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se është i certifikuar me këto standarde: ISO 9001 - certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë, ISO 14001 - certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit, ISO 45001 - certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Do të thotë kërkesa e MSh nuk është kërkesë e **gjendjes ekonomike dhe financiare** (Paragrafi 4 i nenit 68) apo kërkesë e **aftësisë teknike dhe/ose profesionale** Paragrafi 8 i nenit 69, por është kërkesë e përshtatshmërisë profesionale (**certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë**) dhe si rrjedhojë kjo kërkesë ne përputhje me nenin 26.6 të RPP dhe interpretimit të KRPP-se (**certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë**) duhet të përmbushet nga secili anëtar i grupit të OE, prandaj kërkesa e juaj është e pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit